



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 14 prill 2014
Nr.ref.:RK599/14

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI37/14

Parashtrues

Agjencia Kosovare e Privatizimit

**Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Dhomës së
Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, AC-II-12-0078, të 23 janarit
2014, me kërkesën për aplikimin e masës së përkohshme**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Agjencia Kosovare e Privatizimit, Zyra rajonale në Pejë, të cilën e përfaqëson z. Gëzim Gjoshi, zyrtar ligjor në Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: AKP).

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Dhoma e Posaçme), AC-II-12-0078, i 23 janarit 2014, të cilin parashtruesi i kërkesës e ka pranuar më 30 janar 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Dhomës së Posaçme, AC-II-12-0078, me të cilin ankesa e parashtruesit u refuzua dhe Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Klinë, C. nr. 185/2009, mbeti në fuqi, si dhe vlerësimi i kërkesës për masë të përkohshme të paraqitur në kërkesë.

Baza juridike

4. Neni 113.7 lidhur me nenin 21.4 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), neni 22 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe rregulli 56 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

5. Më 3 mars 2014, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 10 mars 2014, Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Ivan Čukalović, Enver Hasani dhe Robert Carolan.
7. Më 11 mars 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës.
8. Më 25 mars 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 2 tetor 2008, paditësit: F. M., N. B., D. M., GJ. R., C. T., të gjithë nga Komuna e Klinës, kanë parashtruar padi në Dhomën e Posaçme kundër të paditurave: 1. Kooperativa Bujqësore “Ujmiri”, me seli pune në fshatin Ujmir, Komuna e Klinës (në tekstin e mëtejme: KB “Ujmiri”) dhe 2. AKP, duke kërkuar kompensimin e të ardhurave personale të papaguara për punën që kanë bërë në KB “Ujmiri”.
10. Më 27 gusht 2009, Dhoma e Posaçme kishte nxjerrë Aktvendimin SCC-008-0264, lëndën, përkitazi me këtë padi, ia kishte referuar për vendosje Gjykatës Komunale në Klinë.

11. Më 15 qershor 2011, Gjykata Komunale në Klinë duke vendosur për padinë e paditësve sipas kompetencës së deleguar nga Dhoma e Posaçme ka nxjerrë Aktgjykimin C. nr. 185/2009, me të cilin ka aprovuar pjesërisht si të bazuar padinë e paditësve: F. M., N. B., D. M., GJ. R., C. T., dhe ka detyruar të paditurat KB dhe AKP-Pejë që t'ua paguajë kompensimin material të të ardhurave personale në shumën e caktuar monetare si në dispozitivin e aktgjykimit.
12. Në arsyetimin e vet, Gjykata Komunale në Klinë kishte shqyrtuar në cilësi të provave kontratat e punës së paditësve, si dhe ka dëgjuar përfaqësuesin e autorizuar të AKP-së dhe lidhur me këtë ka theksuar: *“Nga vërtetimi i këtillë i gjendjes faktike gjykata konkludon se padinë e paditësve duhet aprovuar pjesërisht si të bazuar dhe të drejte në ligj. Ku gjykata në baze të provave dhe leximit të kontratave të punës si dhe përfaqësuesit të të paditurës se detyrë KB ‘Ujmiri’ nga Ujmiri, Fadil Kryeziu ka ardhur në përfundim se padia dhe kërkesa e sajë është e bazuar dhe të njëjtën e ka aprovuar në tersi siç është cekur si në padinë fillestare”*.
13. Kundër këtij aktgjykimi, AKP-ja, në cilësinë e të paditurës, ka bërë ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme.
14. Më 23 janar 2014, duke vendosur sipas ankesës së AKP-së, Dhoma e Posaçme nxori Aktgjykimin AC-II-12-0078 me të cilin ankesën e AKP-së e refuzoi si të pabazuar, ndërsa e vërtetoi Aktgjykimin C .nr. 185/2009 të Gjykatës Komunale në Klinë, të 1 qershorit 2011.
15. Në arsyetimin e aktgjykimit, Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaçme i ka dhënë përgjigje secilit prej pretendimeve të paraqitura në ankesë dhe në mes tjerash ka potencuar: *“Pra, kontratat janë lidhur ndërmjet punëdhënësit NSH ‘Ujmiri’, në njërin anë, dhe paditësve në anën tjetër, pa marrë parasysh se kush ka qene drejtori. Madje edhe drejtori ka qene punëtorë në këtë NSH, dhe ka të drejtën të gëzojë të ardhura për punën që ka bërë dhe që bënë. AKP madje nuk e ka arritur ta kundërshtoj me asnjë provë se paditësit nuk kanë qenë të punësuar në këtë NSH, për periudhën e potencuar nga vete paditësit, ndërsa paditësit kanë prezantuar kontratat e punës të lidhur në fillim të çdo viti”*.
16. Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaçme më tej në aktgjykim arsyeton: *“Sa i përket pretendimit të AKP-se për parashkrimin e kërkesës së paditësve (3 vjet), kjo çështje për here të pare është parashkruar në procedurën ankimore, edhe pse nuk janë specifikuar cilat kërkesa janë parashkruar, ngase shume prej tyre janë bere një ose dy vjet pas ndërprerjes së marrëdhënies së punës. Andaj AKP është e obliguar që t'ua njoh të drejtën për pagesën e të ardhurave këtyre punëtorëve, në përputhje me këtë aktgjykim”*.
17. Përfundimisht, AKP-ja, e pakënaqur me Aktgjykimin e Dhomës së Posaçme, ka paraqitur kërkesë në Gjykatën Kushtetuese.

Pretendimet e parashtruesit

18. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktgjykimin e Dhomës së Posaçme ka:

- i) *Shkelje te kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë te përcaktuar me kapitullin VII, neni 102, paragrafi 3, te Kushtetutës se Republikës se Kosovës, me te cilin përcaktohet se gjykatat gjykojnë ne baze te kushtetutës dhe ligjit;*
- ii) *Shkelje te nenit 31 te Kushtetutës se Republikës se Kosovës, me te cilën është përcaktuar e drejta për një gjykim te drejte dhe te paanshëm;*
- iii) *Shkelje te Konventës Evropiane te të Drejtave te Njeriut (KEDNJ), nenit 6, me te cilën parashihet gjykim i drejte dhe i paanshëm; dhe*
- iv) *Shkelje te parimeve te përgjithshme juridike”.*

19. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon se gjatë nxjerrjes së aktgjykimit të kontestuar është aplikuar gabimisht e drejta materiale dhe se aktgjykimi përmban shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore.
20. Parashtruesi i kërkesës më tej ka theksuar se gjykatat e rregullta nuk kishin zbatuar ligjin e duhur me rastin e marrjes së vendimeve lidhur me kontestin.

Pranueshmëria e kërkesës

21. Për të qenë në gjendje të gjykojë mbi kërkesën e parashtruesit, Gjykata paraprakisht vlerëson nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të parapara me Kushtetutë, me Ligj dhe me Rregullore.
22. Lidhur me këtë, i referohet Kushtetutës, ku përcaktohet:

Neni 113.7

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Dhe, neni 21.4

‘Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejné edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme’

Gjykata, gjithashtu, merr parasysh rregullin 36 të Rregullores, ku përcaktohet:

*“(1) Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:
c) Kërkesa është qartas e bazuar”.*

23. Në këtë drejtim, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit është dorëzuar në Gjykatë nga një person juridik, brenda afatit prej 4 (katër) muajsh të paraparë me Ligj dhe pas shterjes së mjeteve juridike, andaj është e përshtatshme për t’u shqyrtuar në Gjykatë.

Vlerësimi i aspekteve substanciale të kërkesës

24. Gjykata vëren se parashtruesi i saj e konteston Aktgjykimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, AC-II-12-0078 të 23 janarit 2014, me

pretendimin se me këtë aktgjykim i janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë.

25. Gjykata në përgjigje të pretendimeve të ngritura nga parashtruesi i kërkesës për shkelje kushtetuese konstaton se:

Sa i përket nenit 102.3 të Kushtetutës

26. Neni 102, pika 3, i Kushtetutës ka përcaktuar:

“Gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit”.

27. Parashtruesi i kërkesës kishte pretenduar se deri te shkelja e kësaj dispozite kushtetuese ka ardhur ngase gjykatat e rregullta nuk kanë aplikuar dispozitën e duhur ligjore kur kanë nxjerrë vendimin dhe se sipas parashtruesit *“nuk kanë gjykuar sipas ligjit”*.
28. Nga faktet e paraqitura në kërkesë, Gjykata nuk gjen të ketë ndodhur shkelje e kësaj dispozite kushtetuese sepse, në fakt, edhe Gjykata Komunale në Klinë, edhe Dhoma e Posaçme, kanë gjykuar rastin në bazë të ligjit. Fakti se nëse është aplikuar drejt apo gabimisht e drejta materiale është çështje ligjore dhe vetë për vete nuk paraqet bazë për shkelje kushtetuese.

Sa i përket nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së

29. Parashtruesi nuk kishte theksuar qartë në kërkesë se si janë shkelur neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së porse në pjesën e kërkesës të titulluar si - B., Shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore, në pikën 12, kishte potencuar: *“Aktgjykimi ne fjale përmban shkelje te dispozitave ligjore dhe kushtetuese, si dhe ka cenuar standardet ndërkombëtare për një gjykim te drejte, të pavarur dhe te paanshëm, është ne kundërshtim te plotë me dispozitat e nenit 31.2, te Kushtetutës se Republikës se Kosovës dhe me nenin 6, te Konventës Evropiane për te Drejtat e Njeriut (tani e tutje: KEDNJ)”*.
30. Gjykata, me këtë rast, përkujton se Kushtetuta e Kosovës dhe KEDNJ-ja, në dispozitat e kontestuara nga parashtruesi, përcaktojnë:

Neni 31 i Kushtetutës [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

“1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshem, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj”.

[...]

Neni 6.1 i KEDNJ-së

E drejta për një proces të rregullt

“1. Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohe shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë”.

[...]

31. Lidhur me si më sipër, Gjykata thekson se përshkrimi i thjeshtë i dispozitave të Kushtetutës dhe KEDNJ-së dhe konstatimi se ato janë shkelur, pa paraqitur fakte për mënyrën e shkeljes, pa përcaktuar rrethanat, pa specifikuar veprimet e autoritetit publik që bien në kundërshtim me gjykimin e drejtë e të paanshëm nuk janë bazë e mjaftueshme për të bindur Gjykatën se ka pasur shkelje të Kushtetutës apo të KEDNJ-së lidhur me një proces të rregullt dhe të paanshëm.
32. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton se GJEDNJ-ja, nëpërmes praktikës së saj të zhvilluar gjyqësore, lidhur me nenin 6 të KEDNJ-së, ka përcaktuar disa nga elementet themelore që përmban neni 6 i Konventës lidhur me procesin e rregullt, e që ndër të tjera janë:
 - e drejta në qasje (akces) në Gjykatë;
 - e drejta në barazi në proces (barazia e armëve) (*equality of arms*);
 - e drejta në dëgjim publik;
 - e drejta në shpalljen publike të vendimit;
 - e drejta në gjykatë të themeluar me ligj;
 - e drejta në pavarësi dhe paanësi gjatë gjykimit;
 - e drejta në gjykim në kohë të arsyeshme;
 - e drejta në ekzekutimin efektiv të vendimit;
33. Gjykata, duke bërë shqyrtimin e kërkesës së parashtruesit dhe të fakteve të paraqitura në kërkesë, nuk gjen se ndonjëra nga garancitë e theksuara më sipër të jenë cenuar, aq më tepër kur nga vendimet e gjykatave të rregullta shihet qartë se secila veç e veç dhe të gjitha së bashku janë përmbushur në tërësi.
34. Gjykata më tej konstaton se ajo nuk është gjykatë e faktit, nuk gjykon si gjykatë e shkallës së katërt dhe nuk është, thjeshtë, një instancë më shumë gjyqësore. Gjykata, në parim, nuk gjykon faktin nëse gjykatat e rregullta e kanë konstatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike, apo nëse si në rastin konkret kontratat e punës së të punësuarve ishin valide apo jo, sepse kjo është kompetencë e gjykatës së rregullt. Për Gjykatën janë thelbësore çështjet prej ekzistimit të cilave varet vlerësimi për shkelje eventuale të të drejtave kushtetuese dhe jo çështjet qartazi ligjore që kryesisht kanë qenë fakte të paraqitura nga parashtruesi (shih, *mutatis mutandis*, i. a., Akdivar kundër Turqisë, 16 shtator 1996, R.J.D, 1996-IV, para. 65).

35. Lidhur me si më sipër, duhet kujtuar se njëri nga parimet themeltare të gjykimit kushtetues është ai i subsidiaritetit. Në kontekstin e veçantë të Gjykatës, do të thotë që detyra për të siguruar respektimin e të drejtave të parashikuara nga Kushtetuta u takon në radhë të parë autoriteteve vendore gjyqësore dhe jo drejtpërsëdrejti dhe menjëherë Gjykatës Kushtetuese (shih, Scordino kundër Italisë, nr. 1, [DHM], § 140), andaj, në këtë drejtim, Gjykata vëren se edhe çështjes së adresuar nga parashtruesi i kërkesës i ka dhënë përgjigje efektive edhe Gjykata Supreme, duke e arsyetuar me argumente vendimin e marrë.
36. Gjykata rikujton se fakti i thjeshtë që parashtruesit janë të pakënaqur me rezultatin e rastit, nuk mund t'u shërbejë atyre si e drejtë të ngrënë një kërkesë të argumentueshme për shkelje të dispozitave të Kushtetutës (shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së, kërkesa Nr. 5503/02, Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë, ose Aktvendimin e Gjykatës Kushtetuese, Rasti KI128/12, i 12 korrikut 2013, të parashtruesit Shaban Hoxha, në kërkesën për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 316/2011).
37. Në këto rrethana, Gjykata konstaton se faktet e paraqitura nga parashtruesi në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, andaj nuk mund të konstatohet se kërkesa ishte e bazuar dhe, në përputhje me rregullin 36, paragrafi 2, pika b, gjen se kërkesën duhet ta refuzojë si qartazi të pabazuar.

Kërkesa për masë të përkoshme

38. Duke marrë parasysh faktin se kërkesa në tërësi shpallet e papranueshme si qartazi e pabazuar, Gjykata nuk gjen asnjë bazë për aplikimin e masës së përkohshme të kërkuar nga parashtruesi i saj dhe, si e tillë, ajo refuzohet.

PËR KËTO ARSYE

Në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, të nenit 20 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, dhe të rregullit 56 të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese, më 25 mars 2014, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TA REFUZOJË kërkesën për masë të përkohshme;
- III. Ky vendim do t'u kumtohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Altay Suroy



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani